



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 08/L-216

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES PËR NJOHJEN E
KUALIFIKIMEVE TË ARSIMIT TË LARTË NË BALLKANIN
PERËNDIMOR**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES PËR NJOHJEN E
KUALIFIKIMEVE TË ARSIMIT TË LARTË NË BALLKANIN
PERËNDIMOR**

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është ratifikimi i Marrëveshjes për Njohjen e Kualifikimeve të Arsimit të Lartë në Ballkanin Perëndimor.

Neni 2
Ratifikimi i Marrëveshjes

Marrëveshja për Njohjen e Kualifikimeve të Arsimit të Lartë në Ballkanin Perëndimor konsiderohet e ratifikuar me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 08/L-216
23 shkurt 2023

Glauk KONJUFCA

Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës